

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**Pkl.-Kzz. nr. 38/2011**  
**04 maj 2012**

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Francesco Florit si Kryetar i kolegjit, dhe gjyqtari i EULEX-it Horst Proetel si edhe gjyqtarët e Kosovës Emine Mustafa, Salih Toplica dhe Nazmije Ibrahimimi si anëtarë të kolegjit, në praninë e Tara Khan si procesmbajtëse, në seancën e mbajtur më 04 maj 2012 në lëndën penale kundër:

*I. G., me nofkën "...", emri i të atit B., emri vajzërisë së nënës H. Xh., Shqiptar i Kosovës, i lindur më data e lindjes ... në vendi..., me banim të përhershëm në adresa... Malmë, Suedi, konsulent financiar, aktualisht në paraburgim në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë;*

I dënuar nga Gjykata e Qarkut në Pejë<sup>1</sup> për Krime Lufte kundër Popullsisë Civile në kundërshtim të Nenit 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ("KP RSFJ") dhe Nenit 3 dhe 147 të Konventës<sup>2</sup> së Katërt të Gjenevës dhe të Nenit 4 të Protokollit Shtesë II<sup>3</sup>, dhe të vërtetuar për ankesën nga Gjykata Supreme e Kosovës<sup>4</sup>;

Duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të ushtruar nga avokati mbrojtës M. H. më 13 prill 2011;

Në pajtueshmëri me Nenin 451(1) dhe 456 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës ("KPPK"), në seancën e mbajtur më 04 maj 2012, lëshon këtë:

## **AKTGJYKIM**

**Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e ushtruar më 13 prill 2011 nga avokati mbrojtës M. H. REFUZOHET si e PABAZUAR.**

## **ARSYETIMI**

### **I. Historia e procedurës**

Aktakuza PP. nr. 36/2006, sikurse është konfirmuar, e akuzon I. G. për veprën penale Krime Lufte kundër Popullsisë Civile në kundërshtim të Nenit 142 të KP RSFJ.<sup>5</sup> Ai

<sup>1</sup> Aktgjykimi P. nr. 329/2009 i datës 19 nëntor 2009.

<sup>2</sup> Konventa (IV) në lidhje me Mbrojtjen e Personave Civilë në Kohë Lufte, 12 gusht 1949.

<sup>3</sup> Protokollit Shtesë i Konventave të Gjenevës të 12 gusht 1949, dhe në lidhje me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve jo-ndërkombëtar të Armatosura, 8 qershor 1977.

<sup>4</sup> Aktgjykimi Ap.-Kz. nr. 108/2010 i datës 25 nëntor 2010.

<sup>5</sup> Aktakuza PP. nr. 36/2006 e ushtruar nga Prokurori i UNMIK-ut Robert L. Dean më 08 shkurt 2007, e konfirmuar me aktvendimin PP. nr. 36/2006 të Gjykatës së Qarkut në Pejë më 23 mars 2007.

është dënuar për vepër penale me aktgjykimin P. nr. 537/2007 të Gjykatës së Qarkut në Pejë më 22 qershor 2007. Më 02 qershor 2009, Gjykata Supreme anuloi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe kthej lëndën për rigjykim në aktgjykimin e ankesës Ap.-Kz. nr. 465/2008.

Sipas rigjykimit, I. G. u dënua për Krime Luftë kundër Popullsisë Civile me aktgjykimin P. nr. 329/2009 të Gjykatës së Qarkut në Pejë të datës 19 nëntor 2009 dhe u dënua me katërmbëdhjetë vjet burgim. Më 25 nëntor 2010, Gjykata Supreme refuzoi ankesën e të pandehurit kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut si të pabazuar në aktgjykimin e ankesës Ap.-Kz. nr. 108/2010.

I pandehuri ushtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë më 13 prill 2011.

## **II. Analiza Ligjore**

### **A. Cështjet e ngritura në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë**

Kërkesa pretendon se ka pasur shkelje esenciale të procedurës penale, veçanërisht nën pikën (8) të Nenit 403 (1) të KPPK, në atë se aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut ishte i bazuar në prova të papranueshme. Prova në fjalë përbëhet nga deklaratimet e mëparshme të dëshmitarit A. K. i cili është dashur të jetë trajtuar si "dëshmitar bashkëpunues", e jo një "dëshmitar" i rregullt, në të dy gjykimet, të parin dhe të dytin në Gjykatën së Qarkut. Për këtë arsye, kërkesa përmban se të gjitha deklaratimet e tij të mëparshme janë të papranueshme dhe duhet të jenë ndarë nga shkresat e lëndës.

Mbrojtja propozon që Gjykata Supreme ose të modifikoj aktgjykimin e formës së prerë dhe liroj I. G. pasi që nuk është provuar se i pandehuri ka kryer vepër penale, ose të prish aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës Supreme dhe kthej lëndën për rigjykim.

### **B. Përgjigja e ZPShK në Kërkesë**

ZPShK paraqiti përgjigjen më 06 qershor 2011 duke propozuar që kërkesa të pranohet pjesërisht duke modifikuar dispozitivin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme me largimin e referimit në Nenin 147 të Konventës së Katërt të Gjenevës. Përgjigja më tutje propozon që pjesa tjetër e mbetur e kërkesës të refuzohet si e pabazuar, pasi që A. K. në mënyrë të drejtë ka mbajtur statusin e 'dëshmitar' i rregullt gjatë rigjykimit për shkak të përfundimit të hetimit penal kundër tij të ushtruar nga prokurori publik më 15 tetor 2009. Për më tepër, nuk është bërë adresim i mëtejshëm në deklaratimet e mëhershme të A. K. të datës 17 dhjetor 2002 dhe 11 gusht 2005 të cilat janë shpallur të papranueshme nga Gjykata e Qarkut dhe janë ndarë nga shkresat e lëndës. Vetëm deklaratimet e mëhershme të datës 30 janar 2006 dhe 16 maj 2007, të cilat janë prova të pranueshme, janë marrë në konsideratë gjatë rigjykimit.

### **C. Gjetjet e Gjykatës Supreme**

### *1. Pranueshmëria e Kërkesës*

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është ushtruar në kohë nga avokati mbrojtës M. H. dhe pretendon shkelje substanciale të procedurës penale në pajtueshmëri me Nenin 451(1) pika (2) të KPPK. Prandaj kërkesa është e lejuar.

### *2. Pranueshmëria e deklarimeve të mëhershme të A. K.*

Sikurse është arsyetuar mjaftueshëm dhe qartë nga Gjykata Supreme në aktgjykimin e ankesës së tij të parë të datës 02 qershor 2009, statusi i A. K. gjatë gjykimit fillestar ishte “dëshmitar bashkëpunues” përkundër lëshimit të procedurës ligjore për të vërtetuar statusin e tillë. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme po ashtu qartë ka specifikuar pse deklaratimet e mëhershme të A. K. ishin bërë të papranueshme për shkak të këtij gabimi, por që duhet të shqyrtohen nga Gjykata e Qarkut në kontekstin e deklarimeve të dëshmitarit bashkëpunues subjekt i Nenit 157(4) të KPPK. Kjo ishte arsyeja që aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut P. nr. 537/2007 u anulua dhe lënda u kthye për rigjykim.

Para fillimit të rigjykimit, më 15 tetor 2009, prokurori publik ndërpreu hetimet penale kundër A. K. Prandaj gjatë rigjykimit ai ka mbajtur statusin e “dëshmitarit” të rregullt dhe jo “dëshmitar bashkëpunues”. Ky fakt është vë në pah edhe në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut (P. nr. 329/2009 në faqen 32-33) dhe aktgjykimin ankimor të Gjykatës Supreme (Ap.-Kz. nr.108/2010 faqe 5).

Gjatë rrjedhës së rigjykimit, dy deklaratimet e mëhershme të A. K. – të datës 17 dhjetor 2002 dhe 11 gusht 2005 – janë vendosur të papranueshme nga Gjykata e Qarkut dhe janë ndarë nga shkresat e lëndës. Asnjëra nga këto deklaratime nuk janë konsideruar nga Gjykata e Qarkut në aktgjykimin e saj. Deklarimi i mëhershëm i A. K. i dhënë prokurorit publik më 30 janar 2006 dhe dëshmia e tij e mëhershme gjatë gjykimit fillestar në Gjykatën e Qarkut më 16 maj 2007 prandaj mbeten prova të pranueshme, që të konsiderohen në kuadër të statusit të tij si i dyshuar dhe dëshmitar bashkëpunues në kohën kur janë bërë deklaratimet. Kjo është vërtetuar qartë edhe në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut (P. nr. 329/2009 në faqe 33) edhe në aktgjykimin e ankesës së Gjykatës Supreme (Ap.-Kz. nr.108/2010 në faqe 5).

Prandaj nuk ka asnjë meritë në argumentin e paraqitur në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë se deklaratimet e 30 janar 2006 ose 16 maj 2007 duhet të shpallen të papranueshme. As nuk ka ndonjë paqartësi në përdorimin e Gjykatës që Qarkut të deklarimeve të pranueshme siç pretendohet në kërkesë. Prandaj Gjykata Supreme konstaton se nuk ka pasur shkelje të Nenit 403 (1) pika (8), të lexuar në lidhje me Nenin 451 (1) pika (2) të KPPK.

### *3. Përdorimi i Deklarimeve të mëhershme të A. K.*

Neni 157(4) i KPPK parasheh që gjykata nuk duhet të shpallë një person fajtor duke u bazuar vetëm në prova apo dëshmi të dhënë nga dëshmitari bashkëpunues. Ashtu si edhe është shpjeguar, deklaratimet e A. K. më 30 janar 2006 dhe 16 maj 2007 janë të

pranueshme dhe gjatë dëshmisë në rigjykim, ai ka mbajtur statusin e dëshmitarit të zakonshëm.

Nga aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut është e qartë se shpallja fajtor nuk është bazuar vetëm në deklaratimet e A. K. por në tërësinë e provave të cilat përfshijnë deklaratimet vërtetuese të dëshmitarit H. B., C. K., A. U., D. H., H. U., dhe Z. H., si edhe deklaratimet dhe pranimet e vet të pandehurit I. G.<sup>6</sup> Gjykata Supreme konstaton se deklaratimet dhe dëshmia e A. K. janë shqyrtuar drejtë nga Gjykata e Qarkut dhe nuk ishin baza të vetme për shpalljen e tij fajtor. Prandaj nuk ka pasur shkelje të Nenit 157(4) të KPPK.

#### *4. Vërtetimi i gjendjes faktike*

Shumica e faqeve në kërkesën e të pandehurit i dedikohet rindërtimit të gjendjes faktike. Një pohim për vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike nuk mund të jetë bazë për një kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë.<sup>7</sup> Megjithatë Neni 458 i KPPK i kërkon Gjykatës Supreme të shqyrtoj nëse ka "dyshim të konsiderueshëm" për saktësinë e vërtetimit faktik të aktgjykimit të kundërshtuar.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe të aktgjykimit, Gjykata Supreme nxjerr konkluzionin se nuk ka dyshim të konsiderueshëm në lidhje me vërtetimin e gjendjes faktike nga Gjykata e Qarkut.

#### *5. Propozimi i ZPShK për të modifikuar dispozitivin*

Në përgjigjen e saj, ZPShK propozon që Gjykata Supreme të modifikojë dispozitivin e aktgjykimit duke hequr referimin në Nenin 147 të Konventës së Katërt të Gjenevës, sepse Neni zbatohet për shkelje të rënda në rast të një konflikti të armatosur *ndërkombëtar*. Ky ndryshim do të përbënte një ri cilësim të veprës penale, e cila është përtej fushëveprimit të shqyrtimit të Gjykatës Supreme për të vendosur mbi një kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Gjykata Supreme vëren që referimi i bërë Nenit 147 shfaqet vetëm një herë përgjatë aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, në dispozitiv dhe përfshirja e tij ose fshirje nuk ka asnjë pasojë. Nëse citati i tij në dispozitiv është rezultat i një gabimi teknik, atëherë mbetet në Kryetarin e kolegjit të nxjerrë një vendim për korrigjimet në pajtueshmëri me Nenin 397 të KPPK.

Përveç kësaj, pala e vetme që ka parashtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në lëndën aktuale është vetë i pandehuri; kërkesa e prokurorit është futur në përgjigje. Në zbatimin e Nenit 455 të KPPK (Gjykata Supreme kufizohet vetëm në verifikimin e

<sup>6</sup> Shih pp. 6-17, 20-31 të aktgjykimit P. nr. 329/2009.

<sup>7</sup> Neni 451(2) të KPPK.

shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon. '), shkelja e pretenduar nuk mundë të merret në konsideratë.

## II. Konkluzioni

Në kuadër të tërë kësaj që u tha më lart, dhe në pajtueshmëri me Nenin 456 të KPPK, Gjykata Supreme nxjerr përfundimin se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar dhe prandaj refuzohet.

### GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pkl.-Kzz. nr. 38/2011

04 maj 2012

E përpiluar në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.

Kryetari i kolegjit

Zyrtarja ligjore

\_\_\_\_\_  
Francesco Florit

\_\_\_\_\_  
Tara Khan

Anëtar i kolegjit

Anëtare e kolegjit

\_\_\_\_\_  
Horst Proetel

\_\_\_\_\_  
Emine Mustafa

Anëtar i kolegjit

Anëtare e kolegjit

\_\_\_\_\_  
Salih Toplica

\_\_\_\_\_  
Nazmije Ibrahim